



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:058875

Datë: 16.09.2019

Numri i dokumentit: 00513743

P. nr. 653/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti** me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.K., K. Gjakovë, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185/1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/II.nr.1301/18 të datës 21.09.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **06.09.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Mone Sylja, mbrojtësit të akuzuarit S.K. av.T.B., si dhe të akuzuarit S.K., mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **S.K.**, K.Gjakovë, data e lindjes..., i biri i H. dhe i nënës M. e gjinisë S., ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, pensionist, i martuar, atë i 5 fëmijëve, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, numer personal...

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

- me datë **15.08.2018**, K.Gjakovë, seriozisht e ka kanosur me fjalë personin tjetër këtu të dëmtuarin R.K. dhe anëtarët tjerë të familjes së tij, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje rreth një kontesti pronësor në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit, ditën kritike pandehuri përmes rrjetit social Viber, ka kërcënuar nipin A.R.K. dhe të gjithë anëtarët tjerë të familjes së tij me fjalët "nëse nuk me lëshoni tokën ka me ju kallë të gjallë, ke me ja pa sherrin kësaj pune, ka me ja nis prej teje të parin kam me t'vra e ty edhe krejtve me ren", për çka tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë dhe ankth duke e përcjellë me pasiguri për jetën dhe familjen e tij.

- me çka ka kryer veprën penale kanosje nga neni 185/1 të KPRK-ës.

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4,41,43,46,73, nenit 185 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton;

DËNIM ME GJOBË

Dënim gjobë në shumë prej **300 (treqind) euro**, të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që Aktgjykimi të marrë formë të prerë e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së ,atëherë i njëjti i zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)**.

I dëmtuari , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale si dhe ne emër te paushallit gjyqësor shumë prej **30.00 euro** ,ne afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore - DP në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën, PP/II.nr.1301/18 të datës 21.09.2018 kundër të akuzuarit S.K., K.Gjakovë, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së .

Gjykata konstaton se me aktvendimin P.nr. 653/18 te dt. 07.08.2019 , ka pezulluar mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me qene se i akuzuari S.K. nuk ka marr pjesë ne seancën e caktuar për te cilën është lëshuar urdhëresë për shoqërim me detyrim ,mirëpo sipas njoftimit nga st. policor me nr. ref. ..., dt. 06.08.2019, gjykata është njoftuar se i akuzuari ndodhet jashtë shtetit ne Zvicer e kete informim e kanë marr nga vëllai i tij G.K., me nr. tel ...,për të cilën gjykata ka lëshuar edhe urdhër arrest .

I akuzuari është ndaluar nga st. policor ne Gjakovë me dt. 05.09.2019, lidhur me urdhër arrestin, i njëjti është paraqitur sot ne gjykatë me dt. 06.09.2019, i njëjti u procedua dhe u bë tërheqja e urdhër arrestit.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me të datë 06.09.2019, Prokurori i shtetit Mone Syla , lexojë aktakuzën PP/II.nr.1301/18 të datës 21.09.2018 dhe deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari S.K. ,duke u deklaruar lidhur me fajësinë dhe pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësen e tij av. T.B., theksoi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë është penduar për veprën e kryer ne afekt për shkak të një konflikti pronësi juridike te cilën e ka me vëllai e tij R.K., ku mesazhet në fjalë janë refleksion i momentit dhe se unë punoj ne boten e jashtme që 47 vite dhe nuk kam pasur fare qellim që të njëjtin ta kanos seriozisht. Më vjen keq qe ka ardhur deri te kjo situatë pasi që kontestet eventuale do ti zgjidhim në rrugë ligjore, nese nuk arrimë qe ti zgjidhim mes veti me ndonjë marrëveshje andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimi i shprehur ne gjykate, premtimi se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla dhe do te jem me i kujdesshëm, gjendjen time shëndetësore si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë me te cilën do te arrihet qellim i dënimit me te vetmin arsyetim qe kjo çështje te mbyllet për shkak se jetojë ne boten e jashtme dhe kjo çështje me ka penguar qe te kthemë te familja .

Mbrojtësi i te akuzuarit av.T.B., deklaroi se lus gjykatën se me rastin e caktimi e llojit te sanksionit penale te këtë parasysh se falja është për një person te civilizuar i cili jeton ne boten e jashtme dhe se ne fakt te dëmtuarit i ka te afërm dhe se kjo çështje ka ndodhur krejt rastësisht dhe se

duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e tij subjektive edhe dënimi me kusht do të arrihet qëllimi i parapara me KPRK-s

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari prokurori i shtetit Mone Sylja, thekson se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimit të fajësisë, ky pranim është bere pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij ,dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari S.K., **-me datë 15.08.2018 ,K.Gjakovë**, seriozisht e ka kanosur me fjalë personin tjetër këtu të dëmtuarin R.K. dhe anëtarët tjerë të familjes së tij, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje rreth një kontesti pronësor në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit, ditën kritike pandehuri përmes rrjetit social Viber, ka kërcënuar nipin A.R.K. dhe të gjithë anëtarët tjerë të familjes së tij me fjalët “nëse nuk me lëshoni token ka me ju kallë të gjallë , ke me ja pa sherrin kësaj pune ,ka me ja nis prej teje te parin kam me t vra e ty edhe krejtve me ren “, për çka tek i dëmtuari ka shkaktuar frike dhe ankth duke e përcjellë me pasiguri për jetën dhe familjen e tij, me çka ka kryer veprën penale kanosje nga neni 185/1 të KPRK-ës .

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë ,për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë ne pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë ,pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat që i përmban aktakuza, ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpalle fajtor dhe ta gjykojnë ne bazë të ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimin .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, personalitetin e tij se është baba i 5 fëmijëve ,sjelljen korrekte në gjykim, kërkim falja nga i dëmtuari, pendimin e shprehur për veprën e kryer në afekt, premtimin se ne të ardhmen do të jem me i kujdesshëm, me qene se të njëjtin e ka vëlla , si dhe faktin se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, të gjitha këto ndikuan që Gjykata ka ardhur në përfundim që të akuzuarit të shqiptoj dënim me gjobë ne shume prej **300 (treqind) euro** ,do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer, shkallen e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr komfor nenit 463 par. 2 të KPPK-së

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 653/18 më datë 06.09.2019**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë ,në afatin prej **15** ditësh nga dita e marrjes se tij ne dorëzim Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.